



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2058/1 Prot

Rrëshen më, 23 . 06 . 2025

V E N D I M

Nr. 48 datë 19. 06. 2025

PËR

**“MIRATIMIN E HAPJES SË RRUGËS AUTOMOBILISTIKE DALËSE NGA
AUTOSTRADA E KOMBIT NË FUNKSION TË QYTETIT RUBIK, 4603”,
BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, të ligjit 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” *të ndryshuar*, neni 6, gërma “i”, të VKM nr. 408, datë 13. 05. 2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” *të ndryshuar* me VKM nr. 686, datë 22. 11. 2017, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë; (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), *pas shqyrtimit dhe miratimit, në mbledhjen e datës 17. 06. 2025, të Komisionit të Shërbimeve Publike, Transportit dhe Infrastrukturës*, për t’ia kaluar në seancë Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

Duke marrë në konsideratë:

- Rëndësinë strategjike të krijimit të një dalje funksionale nga autostrada drejt qytetit Rubik;
- Nevojën për të përmirësuar aksesin rrugor, lëvizshmërinë e banorëve dhe zhvillimin ekonomik të zonës;
- Kërkesën e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë;
- Konsultimin me ARRSH për rrezikshmërinë që paraqet dalja e vjetër në sensin tjetër të rrugës;
- Dakortësimin me ARRSH për aksin e qytetit në rastin e amortizimit të hyrjes ekzistuese e cila shërben dhe si dalje;

V E N D O S I:

1. Miratimin e hapjes së rrugës automobilistike dalje nga autostrada e Kombit në funksion të qytetit Rubik, 4603, bashkia Mirditë
2. Dalja do të realizohet në koordinim me Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARRSH), Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me standartet teknike dhe sigurisë rrugore

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

3. Pika e lidhjes do të përcaktohet në përputhje me studimin e fizibilitetit dhe dokumentacionit teknik të paraqitur dhe do të përfshijë:
- Ndërtimin e rrugës dalëse nga autostrada e Kombit për në qytetin e Rubikut;
 - Rregullimin e sinjalistikës rrugore dhe ndriçimit;
 - Ndërhyrje në infrastrukturës ndihmëse, nëse është e nevojshme
4. Financimi për realizimin e këtij projekti do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Mirditë
5. Planvendosja SH. 1:2 500, planimetria SH. 1:2 500 dhe relacioni përshkrues drejtuar ARRSH, bashkëlidhur, *pjesë përbërse e këtij vendimi*
6. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë; Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria Juridike për zbatimin dhe ndjekjen e procedurave të mëtejshme, duke përfshirë bashkëpunimin institucional me ARRSH dhe strukturat e tjera shtetërore përkatëse
7. Zbatimi i këtij vendimi, bëhet pasi të plotësohet procedura administrative me konfirmimet e statusit juridik të pronës sipas gjurmës së rrugës, nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar!


SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAKU





**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2058 Prot.

Rrëshen më, 27.05 . 2025

P/VENDIM

Nr. 51 datë 27 . 05 . 2025

PËR

**“MIRATIMIN E HAPJES SË RRUGËS AUTOMOBILISTIKE DALËSE NGA
AUTOSTRADA NË FUNKSION TË QYTETIT RUBIK, BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (të ndryshuar), neni 6, gërma “i”, të VKM.nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, (të ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar,

Duke marrë në konsideratë:

- Rëndësinë strategjike të krijimit të një daljeje funksionale nga autostrada drejt qytetit të Rrubikut;
- Nevojën për të përmirësuar aksesin rrugor, lëvizshmërinë e banorëve dhe zhvillimin ekonomik të zonës;
- Kërkesën e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit së Bashkisë;
- Konsultimin me ARRSH për rrezikshmerinë që paraqet dalja e vjetër në sensin tjetër të rrugës ;
- Dakortësimin me ARRSH për aksesin e qytetit në rastin e amortizimit të hyrjes ekzistuese e cila shërben dhe si dalje ;

V E N D O S I:

1. Miratimin e hapjes dhe ndërtimin e rrugës dalje nga autostrada Kukes-Milot, në përputhje me projektin teknik të paraqitur nga DPZHT.

2. Dalja do të realizohet në koordinim me Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me standardet teknike dhe sigurisë rrugore.
3. Pika e lidhjes do të përcaktohet në përputhje me studimin e fizibilitetit dhe dokumentacionin teknik të paraqitur dhe do të përfshijë:

Ndërtimin e rrugës dalëse nga autostrada për në qytetin e Rubikut;

Rregullimin e sinjalistikës rrugore dhe ndriçimit;

Ndërhyrje në infrastrukturën ndihmëse, nëse është e nevojshme.

4. Financimi për realizimin e këtij projekti do të mbulohet nga buxheti i bashkisë Mirditë,
5. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria Juridike për zbatimin dhe ndjekjen e procedurave të mëtejshme, duke përfshirë bashkëpunimin institucional me ARRSH dhe strukturat e tjera shtetërore përkatëse.
6. Bashkëlidhur planvendosja shkallë 1:2500, planimetria shkallë 1:2500 dhe relacion përshkrues drejtuar ARRSH.
7. Zbatimi i këtij vendimi bëhet pasi të plotësohet procedura administrative me konfirmimet e statusit juridik të pronës sipas gjurmes së rrugës, nga ASHK dhe pas konfirmimit nga ARRSH dhe Institucionet shtetërore përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (të ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETARI

Gasper TOPOLLAJ

KRYETARI

Aleksandër PICAKU

Paraqiti Projektin:

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit :

Juljan TUSHA

Drejtoria Juridik/Prokurimeve:

Manjola DODA

KRYETARI

Albert MËLYSHI

ME DELEGIM KOMPETENCASH

N/KRYETARI

Gjergj PRENGA



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al